

VENDIM
Nr.349, datë 6.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.564, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LICENCIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.564, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4 të bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç. Deklaratë e drejtuesit të shërbimit, ku përcaktohen masa e financimit, burimi dhe kohëzgjatja e tij.”.

b) Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh. Vërtetimet nga organet e gjykatës dhe të prokurorisë, me anë të të cilave vërtetohet se drejtuesi dhe stafi i shërbimit nuk janë në ndjekje penale ose palë në një proces gjyqësor penal, dhe vërtetimin se subjekti nuk është në proces falimentimi. Këto vërtetime duhet të jenë lëshuar brenda tremujorit të fundit, nga çasti i paraqitjes së kërkesës.”.

c) Në shkronjën “ë”, pas shprehjes “... Curriculum Vitae...” shtohen fjalët “... për drejtuesit dhe...”.

2. Në pikën 7 fjalët “... një herë në muaj...” zëvendësohen me “... një herë në dy muaj...”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Tarifa për pajisjen me licencë për ofruesit e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, vendas dhe të huaj, është 10 000 lekë. Tarifa e rinovimit të licencës është 5 000 lekë.”.

4. Në pikën 12 fjalët “... në pikën 3...” zëvendësohen me “... në pikën 4...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha